

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Drejtimin Mësimor

TEKNOLOGJI INFORMATIKI DHE KOMUNIKIMI (TIK)

(PILOT)

Niveli II i KSHK

(2 vjeçar)

Kodi: T/1-II-20

Hartuar me mbështetjen teknike të
Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

Përmbajtja

1	Qëllimet e arsimit profesional	3
2	Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional	3
2.1	Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional	3
2.2	Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim arsimimit	3
2.3	Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit	4
2.4	Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit	4
3	Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin TIK, niveli II i KSHK	5
4	Udhëzime për planin mësimor	6
5	Udhëzime për procesin mësimor	6
5.1	Kompetencat	6
5.2	Struktura e moduleve	6
5.3	Varësitë e moduleve	6
5.4	Cikli i plotë i punës	9
5.5	Projektet praktike	9
5.6	Praktika në kompani	9
6	Udhëzime për vlerësimin dhe provimet	9
6.1	Vlerësimi në modulet profesionale	9
6.2	Ekzaminimi praktikë	9
7	Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional	10
8	Modulet e klasës së 10	11
8.1	Matja dhe interpretimi i energjisë elektrike	11
8.2	Aplikimi i bazave të përpunimit të të dhënave dixhitale	12
8.3	Montimi i një kompjuteri	13
8.4	Instalimi dhe konfigurimi i një kompjuteri	14
8.5	Instalimi i pajisjeve periferike lokale	15
8.6	Puna me mjetet e paketës "office" (zyrë)	16
8.7	Komunikimi në botën e biznesit	17
8.8	Menaxhimi i projekteve të vogla IT	18
9	Modulet e klasës së 11	19
9.1	Zbatimi i një LAN-i të vogël	19
9.2	Vendosja e një kontrolluesi për domain-in	20
9.3	Instalimi i pajisjeve periferike të rrjetit	21
9.4	Instalimi dhe administrimi i sistemeve Linux	22
9.5	Mirëmbajtja dhe administrimi i server-ave	23
9.6	Programimi i faqeve web statike	24
9.7	Mbështetja dhe udhëzimi i përdoruesve	25
9.8	Planifikimi dhe ndërtimi i vendeve të punës me TIK	26
9.9	Aplikimi për punësim	27
10	Module me zgjedhje	28
10.1	Montimi i një pajisje elektronike	28
10.2	Editimi i medias së shtypur	29
10.3	Programimi procedural	30
10.4	Editimi i përmbajtjes së multimedias	31
10.5	Ngritja e server-ave	32
11	Udhëzime për projektet praktike	33

1 Qëllimet e arsimit profesional

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)”, pilot (GIZ) niveli II i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me drejtimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”*.

Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

2 Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional

2.1 Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)”, pilot, niveli II i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2.2 Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim arsimimit

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)”, pilot, niveli II i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithëshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efikente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

2.3 Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)”, pilot, niveli II i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të asemblojë një kompjuter, apo laptop.
- Të instalojë dhe konfigurojë sisteme operative, driver-a dhe skanera-a.
- Të godasë problematikat dhe të riparojë kompjutera dhe pajisje.
- Të vlerësojë dhe të bëjë oferta për infrastrukturë të re IT.
- Të planifikojë dhe të krijojë mjedise pune IT.
- Të udhëzojë dhe të mbështesë përdoruesit.
- Të ngrerë server-a për biznese të vogla.
- Të ngrerë dhe të konfigurojë rrjete të vogla (LAN).
- Të konfigurojë lidhje në Internet.
- Të godasë problematika të vogla në rrjet.
- Të programojë faqe web statike.

2.4 Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)”, pilot, niveli II i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky kualifikim i jep nxënësit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës për punësim në ndërmarrje ose firma që realizojnë riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterave, instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e programeve kompjuterike dhe të rrjeteve kompjuterike, si dhe veprimtari të tjera që lidhen me to.

Me përfundimin e arsimimit për “Teknologji informacioni dhe komunikimi - TIK”, pilot, niveli II i KSHK, nxënësi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III të kualifikimit profesional (dyvjeçar), në një nga profilet mësimorë të këtij drejtimi, duke fituar edhe “Maturën shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmës.

3 Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin TIK (pilot), niveli II I KSHK

Nr	Kodi			Klasa 10	Klasa 11
A. Lëndët e përgjithshme			Orët javore Orët vjetore	13/14 (468/504)	10/11 (340/374)
1		Gjuhë shqipe		1	1
2		Letërsi		1	1
3		Gjuhë e huaj 1		2	2
4		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)		(1)	(1)
5		Matematikë		2	2
6		Fizikë		2	-
7		Kimi		-	2
8		Shkenca sociale		2	-
9		Histori		-	1
10		Gjeografi		1	-
11		Edukim fizik, sporte, shëndet		2	1
B. Module profesionale			Orët vjetore	14 (504)	14 (476)
1	M-11-1086-20	Matja dhe interpretimi i energjisë elektrike		72	
2	M-26-1087-20	Aplikimi i bazave të përpunimit të të dhënave dixhitale		36	
3	M-26-1088-20	Montimi i një kompjuteri		72	
4	M-26-1089-20	Instalimi dhe konfigurimi i një kompjuteri		72	
5	M-26-1090-20	Instalimi i pajisjeve periferike lokale		72	
6	M-26-1091-20	Puna me mjetet e paketës “office” (zyrë)		72	
7	M-17-1092-20	Komunikimi në botën e biznesit		36	
8	M-26-1093-20	Menaxhimi i projekteve të vogla IT		36	
9	M-26-1094-20	Projekt praktik IT #1		36	
10	M-26-1095-20	Zbatimi i një LAN-i të vogël			68
11	M-26-1096-20	Vendosja e një kontrolluesi për domain-in			68
12	M-26-1097-20	Instalimi i pajisjeve periferike të rrjetit			34
13	M-26-1098-20	Instalimi dhe administrimi i sistemeve Linux			68
14	M-26-1099-20	Mirëmbajtja dhe administrimi i server-ave			34
15	M-26-1100-20	Programimi i faqeve web statike			68
16	M-26-1101-20	Mbështetja dhe udhëzimi i përdoruesve			34
17	M-26-1102-20	Planifikimi dhe ndërtimi i vendeve të punës me TIK			34
18	M-17-1103-20	Aplikimi për punësim			34
19	M-26-1104-20	Projekt praktik IT #2			34
C. Module me zgjedhje			Orët vjetore	2 (72)	2 (68)
1	M-12-1105-20	Editimi i medias së shtypur		(72)	(68)
2	M-26-1106-20	Montimi i një pajisje elektronike		(72)	(68)
3	M-26-1107-20	Programimi procedural		(72)	(68)
4	M-26-1108-20	Ngritja e server-ave		-	(68)
5	M-26-1109-20	Editimi i përmbajtjes së multimedias		-	(68)
Gjithsej A+B+C			Orët vjetore	29/30 (1044/1080)	26/27 1044/1116
D. Trajnim në kompani ose administratë publike				min. 4 javë gjatë pushimeve shkollore	



4 Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

- Në klasën 10, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (36 javë mësimorë)
- Në klasën 11 viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimorë + 1 javë provimi i praktikës profesionale + 1 javë provimi i teorisë profesionale).
- Një javë mësimorë ka jo më shumë 30 orë mësimorë (teorike dhe praktike).
- Një orë mësimorë zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Teknologji informimi dhe komunikimi (TIK)”, niveli II i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- A. Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- B. Module profesionale: Bazuar në kompetenca, duke përfshirë teorinë dhe praktikën (shih 5.2).
- C. Module me zgjedhje: Bazuar në kompetenca, duke përfshirë teorinë dhe praktikën.
- D. Praktika e në kompani apo administratë publike.

5 Udhëzime për procesin mësimor

5.1 Kompetencat

Bazuar në supozimin se tregu i punës kërkon forca të trajnuara thellësisht kurrikulumi fokusohet në kompetenca, dhe jo vetëm në njohuritë teorike. Përveç dijes, një forcë punëtore e kualifikuar ka nevojë edhe për aftësitë e duhura dhe një qëndrim, apo qasje të përshtatshme.

→ Kompetenca = Njohuri + Aftësi + Qasje

5.2 Struktura e moduleve

Rezultatet mësimore për lëndët profesionale janë të strukturuar në module. Çdo modul përfshin një kompetencë të veçantë dhe përshkruan të tre nivelet e njohurive, aftësive dhe qasjeve për këtë kompetencë.

Kompetencat, idealisht, mësohen dhe trajnohen në një mënyrë praktike dhe të orientuar drejt veprimit. Për këtë arsye, nuk ka dallim të qartë mes teorisë dhe praktikës në përshkrimin e moduleve. Megjithatë, teoria mund të mësohet më tej, e izoluar, duke pasur parasysh njohuritë e dhëna në një modul.

Me kohëzgjatjen fikse prej 36 ose 72 orëve, një modul është gjithmonë një shumëfish i gjashtë orëve, ose një ditë shkollore. Ky fakt lehtëson planifikimin e mësimëve në shkollë pa qenë shumë kufizues. Modulet, idealisht, mësohen dhe trajnohen në blloqe gjysëm-ditore (3 orë), ditë të plota (6 orë), ose edhe javë.

5.3 Varësitë e moduleve

Të gjitha modulet e këtij programi mësimor i janë caktuar një të ashtuquajturë fushë kompetence. Një fushë kompetence përfaqëson një sektor të specializuar të bizneseve të

TIK, i cili kërkon një grup të veçantë kompetencash të cilat lejojnë përmbushjen e detyrave të dhëna dhe problemeve në këtë sektor.

Caktimi i moduleve në një fushë kompetence lejon nxjerrjen më mirë dhe më lehtë në dukje të profilit profesional, si dhe të marrëdhënieve midis moduleve. Më tej, i lejon mësuesve të zhvillojnë një udhëzues didaktik metodik të qëndrueshëm përmes moduleve.

Figura më poshtë tregon kombinimin tematik të moduleve me fushat e kompetencës dhe për rrjedhojë edhe marrëdhëniet mes të moduleve. Përveç kësaj, varësitë janë deklaruar në mënyrë të qartë si parakushte, në përshkrimin e moduleve më poshtë në këtë dokument.

		Menaxhim Biznesi	Menaxhim Hardware-i	Menaxhimi rrjeti	Menaxhim Sistemi	Menaxhim projekti	Multimedia	Inxhinieri aplikacionesh	Inxhinieri Web
Klasa 11					Ngritja e server-ave M-26-1108-20				
					Linux M-26- 1098-20				
					Udhëzimi i përdoruesve M- 26-1101-20				
	Provim Niveli 1			Instalim periferikë në LAN M-26-1097- 20	Mirëmbajtja e Server-ave M- 26-1099-20				
	Projekt IT #2 M-26-1104-20	Aplikimi në punë M - 17-1103-20		Zbatim një LAN i vogël M- 26-1095-20	Kontrolluesi i Domain-it M- 26-1096-20	Mjedise pune IT M-26 1102- 20	Multimedia M-26 -1109-20	Prog. Procedural M-26-1107-20	Faqe Web statike M- 26-1100-20
Klasa 10			Montim pajisje elektronike M-12-1105- 20						
			Pajisjet periferike M-26 1090-20						
			Montim kompjuteri M-26- 1088-20						
		Komunikimi në biznes M-17-1092- 20	Procesimi digital M-26-1087- 20						
	Projekt IT #1 M-26- 1094-20	Paketa "office" 26- 1091- 20	Matja e elektricitetit M-11- 1086- 20		Instalimi i kompjuterave M- 26 -1089- 20	Projekte të vogla IT M-26- 1093-20	Media e shtypur M-26 - 1106-20	Prog. Procedural M-26 -1107- 20	
Legjenda	Module të detyrueshme		Module në zgjedhje		Projekte praktike		Provime		

5.4 Cikli i plotë i punës

Shumë kompetenca kryesore të rëndësishme, të tilla si planifikimi, testimin apo dokumentimi i punës personale nuk mund të caktohen në një modul të vetëm. Ato duhet të trajnohen përmes moduleve dhe në varësi të kontekstit teknik, në mënyrë të përsëritur në secilin modul.

Për të mbështetur këtë qasje aftësitë në një modul janë përshkruar kryesisht si cikël i plotë pune, ose veprimtari vetë-përmbajtëse. Një cikël i plotë pune duhet të përmbajë së paku këto faza të përgjithshme:

1. Analiza: Mbledhja dhe analizimi i informacionit të nevojshëm.
2. Planifikimi: Planifikimi i detyrave specifike dhe hapave të punës.
3. Vendimi: Përzgjedhja e një qasjeje ose zgjidhjeje, realiste dhe adekuate.
4. Zbatimi: Realizimi i detyrave.
5. Kontrolli: Sigurimi e cilësisë dhe kontrollini i progresit të punës.
6. Vlerësimi: Duke njohur mësimet e nxjerra.

5.5 Projektet praktike IT

Në çdo vit, studentët kanë për të realizuar një projekt IT të vogël. Qëllimi i këtij projekti praktik është të kombinojë të gjitha kompetencat e fituara gjatë vitit shkollor me ato të një moduli përfshirë punën praktike. Udhëzime specifike për organizimin dhe zbatimin e këtyre projekteve mund të gjendet në kapitullin 11.

5.6 Praktika në kompani

Përpara përfundimit të klasës së 11, çdo student duhet të ketë të paktën 4 javë përvojë praktike shtesë, në një kompani. Këto praktika duhet të kryhen gjatë pushimeve shkollore dhe drejtohen nga shkolla. Çdo shkollë nxjerr udhëzime të veçanta për organizimin dhe zbatimin e këtyre praktikave.

6 Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

6.1 Vlerësimi në modulet profesionale

Mësuesit shqyrtojnë dhe vlerësojnë progresin e të mësuarit të nxënësve me teste, provime, ose produkte dhe rezultate specifike. Çdo modul profesional rezultaton në një notë (4-10), që shënohet në certifikatën vjetore të shkollës.

6.2 Ekzaminimi praktikë

Pas vitit të 11, zhvillohet një provim praktik. Ky provim përfundimtar përbëhet nga tre elemente:

- A. Projekt, apo detyrë praktike (60% të peshës së notës totale): Ky element përmban detyra të ndryshme praktike një shumicë modulesh të dhëna. Teoria nuk do të shqyrtohet e izoluar. Rezultatet vlerësohen nga mësuesit në bazë të kriterëve të caktuara, të cilat janë zhvilluar njëkohësisht me detyrat.
- B. Prezantimi (20%): Studentët duhet të paraqesin dhe diskutojnë rezultatet e tyre përpara një bordi vlerësues, i cili përbëhet nga përfaqësues të stafit mësimdhënës dhe bizneset.

- C. Diskutim profesional (20%): Pas prezantimit bordi vlerësues diskuton në formë gojore me nxënësin dhe vlerëson qasjen, ose qëndrimin e tij, si dhe përgatitjen teorike.

7 Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)”, pilot, niveli II i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
- rezultatet në lëndët e përgjithshme dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
 - rezultatet e provim përfundimtare të Nivelit II i KSHK.

8 Modulet e klasës së 10

8.1 Matja dhe interpretimi i energjisë elektrike

Titulli	Matja dhe interpretimi i energjisë elektrike
Kodi	M-11-1086-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Hardware-i
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	asnjë
Kohëzgjatje	72 orë
Kompetencë	Matja e rezistencës, tensionit dhe rrymës në qarqet dhe pajisjet elektrike dhe elektronike dhe interpretimi i rezultateve të matjes. Zbatimi i masave të mbrojtjes gjatë punës me energji elektrike.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> Diferencimi i burimeve të energjisë elektrike. Të njohurit e rrezikut nga energjia elektrike për njeriun dhe zbatimi i masave të mbrojtjes. Të njohurit e rrezikut nga shkarkesat elektrostatike (ESD) për komponentët dhe zbatimi i masave të mbrojtjes. Llogaritja e tensionit, rrymës, rezistencës në qarqet DC. Matja e karakteristikave elektrike të komponentëve dhe të lidhjeve elektrike.
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> <ul style="list-style-type: none"> Njësitë fizike të tensionit, rrymës dhe rezistencës. Diferenca midis DC dhe AC. Burimet e energjisë të tilla si bateri, furnizimit të energjisë uninterruptible (UPS) dhe prizat elektrike 230 VAC. Funksioni themelor i kutisë së ushqimit të energjisë në kompjutera. <ul style="list-style-type: none"> Rreziqet e energjisë elektrike dhe efektet në trupin e njeriut (IEC 479), rryma vdekjeprurëse. Masat parandaluese dhe mbrojtëse personale të mbrojtjes (shuarja, izolimi, përcjellësit mbrojtës, pajisje rryme rezistente). Ndihma e parë pas aksidenteve me energji elektrike. <ul style="list-style-type: none"> Burimi dhe gjeenrimi i ngarkesës elektrostatike tek personat. Efektet e dëmshëm të shkarkesës elektrostatike (ESD) për komponentët elektronike. Masat për parandalim dhe mbrojtje të komponentëve elektronike nga shkatërrimi si pasojë e shkarkesës elektrostatike (ESD). <ul style="list-style-type: none"> Parimet dhe rregullat e Kirchoff '. Parimet dhe rregullat e Ohm. Llogaritja e rezistencës elektrike dhe rënies së tensionit në kabllot elektrike. Llogaritja e fuqisë dhe shpenzimit të energjisë. <ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i multimetrave analog dhe dixhitalë. Matja e rezistencës elektrike. Matja e tensionit elektrik në qarqet AC dhe DC. Matja dhe testimi i baterive, kutive të ushqimit dhe siguresave. Verifikimi i rezultateve të matjes me llogaritje.
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> Parandalimi i rreziqeve elektrike. Asgjesimi i duhur dhe riciklimi i baterive të përdorura. Përdorimi i energjisë në mënyrë ekonomike.
Objekti	Sistemet dhe komponentët elektrikë me DC dhe AC, si bateri (bord kryesor, telefon celular), siguresat, kutitë e ushqimit në kompjuter, karikues, prizat energjie 230 VAC, portat USB, etj.

8.2 Aplikimi i bazave të përpunimit të të dhënave dixhitale

Titulli	Aplikimi i bazave të përpunimit të të dhënave dixhitale
Kodi	M-26-1087-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Hardware-i
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	Asnjë
Kohëzgjatje	36 orë
Kompetencë	Shpjegimi i përpunimit të të dhënave dixhitale me bit-e, byte dhe operacionet themelore logjike dhe konvertimi I numrave mes sistemeve më të përdorshme të numërimit.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi i bit-it dhe byte-ve për ruajtjen e informacionit dixhital. 2. Konvertimi i numrave mes sistemeve më të përdorshme të numërimit. 3. Interpretimi me gojë i skemave dixhitale me porta logjike dhe realizimi i qarqeve të thjeshta. 4. Shpjegimi i dallimit mes sinjaleve analoge dhe dixhitale dhe dhënie shembujsh praktikë të konvertimit analog/dixhital në fushën e IT.
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> 1. <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi i një shifre binare - Bit. • Përkufizimi i një Byte me një nibble (fragment 4-bits) të ulët dhe të lartë. • Bit si një memorje për vlerat 0 dhe 1. • Sistemi numëror binar (I dyfishtë) me bazë 2. • Fuqitë e dhjetës dhe vlerat e saj dhjetore në sistemin binar (kilo, mega, giga, etj.) 2. <ul style="list-style-type: none"> • Sistemet binar, decimal, oktal dhe hexadecimal. • Konvertimi manual i numrave dhjetorë në modelet binare dhe anasjelltas. • Konvertimi i modeleve binare në numra hex dhe anasjelltas. • Konvertimin modeleve binare në numra oktal dhe anasjelltas. 3. <ul style="list-style-type: none"> • Tabela e operatorëve Boolean JO, DHE, OSE dhe XOR (NOT, AND, OR XOR). • Operacione algjebrike Boolean të thjeshta (të anasjelltën, mbledhjet dhe zbritjet e numrave). • Simbolet IEC dhe DIN për JO, DHE, OSE, XOR. • Qarqe të thjeshta me porta logjike. 4. <ul style="list-style-type: none"> • Sinjalet analoge me informacion të vazhdueshëm. • Sinjalet dixhitale si sinjale të përsëritura me informacione të graduara. • Shembuj të sinjaleve analoge (valë zëri, dritë, etj.). • Funksioni themelor i një konvertimi analog/digjital (korrelacioni mes sinjaleve, norma e mostrave dhe zgjidhja). • Shembuj të Konvertimit-AD në karta grafike, karta zëri, etj.
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> • Të tregojë aftësinë për abstragim. • Të provojë fleksibilitet mendor.
Objekti	Qarqet e thjeshta dixhitale.

8.3 Montimi i një kompjuteri

Titulli	Montimi i një kompjuteri
Kodi	M-26-1088-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Hardware-i
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	Asnjë
Kohëzgjatje	72 orë
Kompetencë	Përzgjedhja e komponenteve të brendshëm hardware për një kompjuter, montimi i komponentëve hardware të një kompjuteri, konfigurimi i BIOS-it dhe testimi i funksionimit të kompjuterit.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e kërkesave dhe nevojave të një klienti për një kompjuter. 2. Krahasimi i komponentëve dhe pajisjeve të ndryshme për sa i përket karakteristikave elektrike, performancës dhe pajtueshmërisë dhe dalja me një listë të plotë të komponentëve. 3. Konsultimi i manualeve teknike dhe burimeve online përpara assemblimit. 4. Asemblimi dhe lidhja e komponentëve hardware. 5. Testimi i funksionimit korrekt të hardware-it dhe dokumentimi i testeve.
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> 1. <ul style="list-style-type: none"> • Funksioni i komponentëve bazikë në kasë dhe kutinë e ushqimit, motherboard, procesor, ram, hard drive, kartë grafike, monitor, tastierë dhe mouse (miut). • Karakteristikat kryesore të komponentëve në aspektin e performancës dhe të çmimit. 2. <ul style="list-style-type: none"> • Dallimet e komponentëve në aspektin e llojeve, madhësisë së paketimit, formës dhe karakteristikave të tyre për pajtueshmërinë. 3. <ul style="list-style-type: none"> • Manualët si një burim për informacione të rëndësishme. • Rradha korrekte dhe e dobishme për montimin e komponentëve. 4. <ul style="list-style-type: none"> • Rreziqet, masat parandaluese dhe masat mbrojtëse kur punohet me energji elektrike. • Rreziqet, masat parandaluese dhe masat mbrojtëse nga shkarkimi elektromagnetik (ESD). • Njohja e instrumentave për assemblim dhe montim (kacavida, etj.). • Prizat/portat dhe ngjyrat e ndryshme të një kutie ushqimi elektrik. • Ndërfaqe/priza/sistemet "bus" të brendshme në një motherboard (IDE, EIDE, ATX, PCI, etj.) dhe karakteristikat e tyre. • Montimi dhe ftohja e një procesori. 5. <ul style="list-style-type: none"> • BIOS-i dhe funksionet kryesore në kompjuter x86. • Përditësimi i BIOS-it (pa SO, me CD të boot-ueshme, apo USB). • Mundësitë për testim hardware-l (LED, beep-et e motherboard-it, BIOS). • Aspektet formale të një skeme të thjeshtë testi (listë-kontrolli).
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> • Respektimi i nevojave dhe dëshirave të një klienti. • Zhvillimi, formulimi dhe komunikimi i urdhërave specifikë të klientit. • Mbajtja e rregullit dhe pastërtisë në vendin e punës. • Përmirësimi i procesit të strukturuar të troubleshooting (goditjes së problematikave). • Të zhvilluarit e këmbënguljes dhe durimit në troubleshooting. • Testimi dhe sigurimi i cilësisë, si sjellje standard (default).
Objekti	Komponentët hardware për kompjuter, laptop dhe server (pa SO) të tilla si kasa, kuti ushqimi, motherboard, procesor, RAM, hard drive, kartë grafike, monitor, tastierë dhe mouse (mi).

8.4 Instalimi dhe konfigurimi i një kompjuteri

Titulli	Instalimi dhe konfigurimi i një kompjuteri
Kodi	M-26-1089-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Sistem-i
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	M-26-1088-15: Asemblimi I një kompjuteri
Kohëzgjatje	72 orë
Kompetencë	Instalimi i sistemit operativ, driver-ave, software-it antivirus dhe paketës “office”, lidhja e kompjuterit në Internet dhe testimin funksionit të kompjuterit.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Instalimi i sistemit operativ (OS) dhe dokumentimi i instalimit. 2. Krijimi i particioneve dhe formatimi me filesystem-in e duhur. 3. Instalimi dhe përditësimi i driver-ave për hardware-in në përdorim. 4. Instalimi i një software-i antivirus dhe paketës “office” duke përdorur konfigurimin standard. 5. Konfigurimi i lidhjes në Internet dhe duke marrja e masave për të mbrojtur kompjuterin nga viruset. 6. Testimi funksionimit korrekt të SO, pajisjeve dhe aplikacioneve të instaluara dhe dokumentimi i rezultateve të testeve.
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> 1. <ul style="list-style-type: none"> • SO si ndërfaqe midis hardware-it dhe aplikacioneve, apo përdoruesit. • Struktura dhe funksionet e një SO (Proces, Memorje, Menaxhimi skedash dhe I/O). • Pasqyrë e tregut, dallimet dhe qëllimet operacionale të SO më të përhapur aktual. • Kërkesat e sistemit për një instalim të suksesshëm. • Kushtet e licensave të software-ve dhe pasojat e abuzimit. • Qëllimi dhe arsyet për një regjistrim të saktë të SO. • Konsideratat për sigurinë, mbrojtjen dhe privatësinë. • Konfigurimi i shërbimeve për përditësim (update). 2. <ul style="list-style-type: none"> • Funksioni i filesystem-it (sistemit të skedave). • Krahasimi i filesistem-eve më të njohur (FAT, NTFS, EXT, etj.). • Particionimi (ndarja) i kujtesës masive (HDD). • Master Boot Record (MBR). 3. <ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi dhe funksioni i driver-it. • Burime të besueshme dhe të sigurta për shkarkimin e driver-ave. • Mënyrat e ndryshme për të instaluar një driver. • Menaxheri i pajisjeve (device manager) në SO dhe informatat e ofruara. 4. <ul style="list-style-type: none"> • Kërcënimet dhe llojet e vireseve. • Mundësitë dhe kufizimet e software-it antivirus. • Kushtet e licensës së software-it dhe pasojat e abuzimit. • Përditësimi dhe mirëmbajtja periodike. 5. <ul style="list-style-type: none"> • Konfigurimi me IP dinamike i ndërfaqes së rrjetit (- nuk ka nevojë të shpjegohet I gjithë konfigurimi i TCP/IP në këtë pikë). • Komandat <i>ping</i> dhe <i>tracrt</i> për të kontrolluar lidhjen e Internet-it në nivel SO 6. <ul style="list-style-type: none"> • Device Manager për kontrollonin gabimet dhe paralajmërimet e pajisjeve. • Event Viewer për të parë gabimet dhe paralajmërimet e aplikacioneve. • Aspektet formale të një plani të thjeshtë për testet (listë-kontrolli).
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> • Pranimi i ligjeve dhe marrëveshjeve të licensës. • Dokumentimi i punës si sjellje standarde. • Përmirësimi i procesit të strukturuar të troubleshooting (goditjes së problematikave). • Të zhvilluarit e këmbënguljes dhe durimit në troubleshooting. • Testimi dhe sigurimi i cilësisë si sjellje standard (default).
Objekti	PC me lidhje në Internet, sistemi operativ me ndërfaqe grafike përdoruesi (p.sh. Windows, Linux me KDE, ose Gnome), paketa “office” (p.sh. Microsoft Office, Open Office) dhe software antivirus.

8.5 Instalimi i pajisjeve periferike lokale

Titulli	Instalimi i pajisjeve periferike lokale
Kodi	M-26-1090-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Hardware-i
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	M-26-1089-15: Instalimi dhe konfigurimi i një kompjuteri
Kohëzgjatje	72 orë
Kompetencë	Instalimi, konfigurimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve periferike lokale dhe troubleshooting problemet me pajisjet.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve periferike lokale, të tilla si printer, skaner, fotokopje, faks dhe kamera dixhitale. 2. Identifikimi i dritareve kohore bosh për mirëmbajtjen dhe zhvillimi i orareve të mirëmbajtjes dhe protokollet e mirëmbajtjes. 3. Mirëmbajtja e pajisjeve periferike dhe gjurmimi në protokollet e mirëmbajtjes. 4. Troubleshooting dhe ndreqja sistematike e gabimeve, siç janë kutitë e ushqimit të dëmtuara, cilësi e dobët e output-it, konfigurime jo-korrekte, etj. 5. Asgjesimi i pajisjeve dhe materialeve të përdorura, ose të riparueshme (shirita, toner, etj.).
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> 1. <ul style="list-style-type: none"> • Funksionet dhe parimet operative të pajisjeve periferike. • Ndërfaqet/prizat e jashtme të periferikëve dhe karakteristikat e tyre (USB, PS2, COM, Serial, HDMI, VGA, DVI, RJ45, Audio / Cinch / Jack etj.). • Procedura për një instalim pa gabime të pajisjeve periferike (kontrolli i përmbajtjes së paketës, konsultimi i udhëzimeve dhe specifikimeve të instalimit nga prodhuesi, lidhja e pajisjes, instalimi i driver-it, testimi i pajisjes). • Qëllimi dhe funksioni i driver-ave. • Burime të besueshme dhe të sigurta për shkarkimin e driver-ave. • Mënyra të ndryshme për të instaluar një driver. 2. <ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi dhe arsyet për mirëmbajtjen parandaluese të pajisjeve (jeta, disponueshmëria, garancia, cilësia, etj.). • Kriteret e rëndësishme (orë operative, kohëzgjatja, intensiteti i përdorimit, kushtet mjedisore, etj.), që duhet të merren parasysh kur krijohen oraret e mirëmbajtjes. • Elementet thelbësore për oraret e mirëmbajtjes dhe protokollet. 3. <ul style="list-style-type: none"> • Specifikimet e manualeve për mirëmbajtjen e pajisjeve. • Struktura dhe përdorimi i potokolleve të mirëmbajtjes. • Mirëmbajtja periodike e pajisjeve (pastrimi, testet për print, kalibrimi, etj.) • Mjete të veçanta, pjesë këmbimi dhe pjesë ndihmëse për mirëmbajtje. 4. <ul style="list-style-type: none"> • Metodatat dhe procedurat për troubleshooting. • Korrektimi i gabimeve dhe riparimi i pajisjeve periferike. • Testimi i pajisjeve periferike pas riparimit. • Rregulloret e garancive. 5. <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloret për asgjësimin e pajisjeve dhe materialeve të përdorura. • Mundësitë e riciklimit.
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptimi i rëndësisë së planifikimit dhe lajmërimit për ndërprerjet e mirëmbajtjeve. • Testimi dhe sigurimi i cilësisë si sjellje standard. • Përmirësimi i troubleshooting të strukturuar. • Të zhvilluarit e këmbënguljes dhe durimit në troubleshooting. • Asgjesimi ose riciklimi i duhur i pajisjeve dhe materialeve, të përdorura ose të riparueshme.
Objekti	PC dhe pajisje periferike lokale, të tilla si printer, skaner, sisteme zëri, fotokopje, faks, kamera dixhitale dhe projektorë.

8.6 Puna me mjetet e paketës “office” (zyrë)

Titulli	Puna me mjetet e paketës “office”
Kodi	M-26-1091-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Biznesi
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	Asnjë
Kohëzgjatje	72 orë
Kompetencë	Krijimi, strukturimi dhe stilimi i dokumenteve profesionale me mjete për përpunim teksti, spreadsheets dhe prezantime.
Aftësi	<p>1. Konfigurimi i një dokumenti të ri (gjuha, pamja e faqes, koka dhe fundi), shkrimi dhe strukturimi i përmbajtjes (titujt, paragrafët, seksionet) me stile dhe dizajne të standardizuara.</p> <p>2. Formatimi i përmbajtjes së dokumenteve në mënyrë të qartë me tab-e dhe tabela.</p> <p>3. Organizimi i të dhënave dhe informacionit në një spreadsheet, duke aplikuar formula dhe funksione për llogaritje dhe për të krijuar grafikë të thjeshtë.</p> <p>4. Konfigurimi i slide-ve të reja për një prezantim (gjuha, koka dhe fundi), shkrimi, strukturimi dhe animimi i përmbajtjes me stile dhe dizajne të standardizuara.</p>
Njohuri	<p>1.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturimi i elementeve, si faqe, seksion, paragraf, linjë dhe karakter. • Konfigurimi i faqes me formate, kufijtë e faqes, etj. • Koka dhe fundi, numrat e faqes. • Karakteristikat e shkrimit (tipi, madhësia, stili). • Koncepti dhe përdorimi i stileve. • Krijimi i tabelave të përmbajtjes. <p>2.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tabulator-ët, ndalesat e tab-eve. • Futja dhe redaktimi i tabelave në dokumente. • Dokumentet me multi-kolona. <p>3.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formatet e celulave për tekst, numra, data, etj. • Formulatat për llogaritje aritmetike. • Funksionet themelore SUM, COUNT, AVG, MAX, MIN etj • Kushtet me IF (nëse). • Llojet e diagramave dhe përdorimi i tyre. • Klasifikimi dhe filtrimi i të dhënave. <p>4.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pamja e slide-ve • Koka dhe fundi, numrat e faqes në slide. • Përcaktimi i konfigurimeve për të gjitha slide-t me përdorimin e master slide.
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkimi për zgjidhje në ndihmën (online) të paketës “office”. • Diskutimi dhe krahasimin zgjidhje të ndryshme.
Objekti	PC me një përdorues, me SO dhe paketë “office” (p.sh. Microsoft Office, Open Office).

8.7 Komunikimi në botën e biznesit

Titulli	Komunikimi në botën e biznesit
Kodi	M-17-1092-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Biznesi
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	M-26-1091-15: Puna me mjetet e paketës "office"
Kohëzgjatje	32 orë
Kompetencë	Shkrimi i letrave dhe email-eve profesionale dhe mbajtja e një bisedë telefonike në mënyrën e duhur në botën e biznesit. Përdorimi i Internetit në mënyrë të sigurtë, gjetja e informacionit në mënyrë efikase dhe vlerësimi kritik i informacionit.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> Shkrimi i letrave profesionale dhe formalisht korrekte. Shkrimi dhe dërgimi i një poste elektronike, profesionale dhe formalisht korrekte. Mbjtja e një bisedë telefonike në mënyrën e duhur. Gjetja e informacionit në Internet në mënyrë të sigurtë dhe efikase. Vlerësimi kritik i informacioneve nga Interneti.
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> <ul style="list-style-type: none"> Kërkesat formale për një letër. Elementet e një letre formalisht të saktë (adresa e dërguesit dhe marrësit, data, subjekti, teksti, formula përshëndetëse, etj.). Formatet e letrës dhe zarfit (DIN A4, C4, etj.). <ul style="list-style-type: none"> Kërkesat formale për një e-mail. Dallimet mes komunikimit postar privat dhe të biznesit. Rregullat për email të saktë në botën e biznesit (netiquette). Dallimet dhe përdorimi korrekt i TO, CC dhe BCC në email. Përdorimi korrekt i bashkangjitjeve në email (madhësia max., formati pdf, etj.). Rreziqet e email-it (spam, virus, etj.). <ul style="list-style-type: none"> Zëri dhe efekti i zërit. Dallimet në mes komunikimit telefonik privat dhe atij të biznesit. Struktura e numrave të telefonit dhe përdorimi i prefikseve ndërkombëtare. Rregullat e përgjithshme për telefonata profesionale. Aplikimet e telefonisë dhe thirrjeve për konferencë në Internet (p.sh. Skype, TeamViewer, etj.). <ul style="list-style-type: none"> Ekspozimet dhe rreziqet në Internet. E drejta e autorit në Internet. Ligjet për krimin kibernetik. Dallimet mes HTTP-së dhe HTTPS-së (pa detaje në lidhje me protokollet). Struktura e URL-së. Burimet e ndryshme në Internet, të tilla si direktoritë (katalogët), portalet, komunitetet, forumet dhe dhomat e bisedave. Motorët popullorë të kërkimit dhe mundësitë për të kërkuar efektshëm. Motorët e kërkimit "meta". <ul style="list-style-type: none"> Besueshmëria e burimeve dhe informacionit. Analizimi i burimeve nga URL dhe vlerësimi kritik i rezultateve të kërkimit.
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> Zakonet, traditat dhe mënyrat në botën e biznesit. Bindja dhe besimi në komunikim. Vlerësimi kritik i informacionit në Internet.
Objekti	Mjedis pune TIK standard në një biznes, me kompjuter dhe telefon (ose kufje).



8.8 Menaxhimi i projekteve të vogla IT

Titulli	Menaxhimi i projekteve të vogla IT
Kodi	M-26-1093-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Projekt
Niveli	Klasa 10 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	Asnjë
Kohëzgjatje	32 orë
Kompetencë	Menaxhimi i projekteve të vogla me objektiva, kërkesa, burime të dhëna dhe afate, të përcaktuara qartë.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> Kontrulli i mundësive të një projekti në raport me burimet, kushtet dhe afatet. Identifikimi i problemeve dhe rreziqeve në projekt dhe përcaktimi i masave përkatëse. Krijimi i një projekt-plani për menaxhimin sistematik të projektit, duke marrë parasysh ndarjen e punës, burimet, oraret, piketat dhe rezervat. Monitorimi dhe dokumentimi i progresit të projektit dhe ndërhyrjeve të hershme në rast të problemeve dhe vonesave. Testimi i rezultateve (të zgjidhjes) të projektit dhe transferimi i tij tek klienti. Vlerësimi dhe pasqyrimi i projektit me ekipin e projektit dhe regjistrimi i konkluzioneve për përmirësime në të ardhmen.
Njohuri	<ol style="list-style-type: none"> <ul style="list-style-type: none"> Karakteristikat e një projekti si objektivat, kërkesat, burimet (njerëzore, materiale dhe financiare) dhe koha. Rolet kryesore në një projekt të tilla si klient, menaxher projekti dhe ekip projekti. Kushtet dhe ndikimi i tyre në terma të fizibilitetit të kohës (p.sh. numri dhe disponueshmërinë e të punësuarve, numri i ditëve të punës deri në afatin përfundimtar, disponueshmëria e burimeve materiale, etj.). Kushtet dhe ndikimi i tyre në drejtim të fizibilitetit të përmbajtjes (p.sh. aftësitë e punonjësve, kushtet teknologjike, eksperiencia, etj.). <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i varianteve dhe alternativave për zgjidhjet. Vlerësimi i performancës reale për orë pune, si bazë e planifikimit. Vlerësimi i përpjekjes për zbatimin. <ul style="list-style-type: none"> Fazat tipike në ciklin e projektit. Ndarja e ngarkesës së punës në detyra të vogla (paketa) me një prodhim të mirë-përcaktuar. Mundësitë e përpunimit paralel të detyrave, me burime shumëfishe. Alokimi i burimeve dhe përgjegjësi për detyrat. Planifikimi i kohës rezervë për probleme të paplanifikuara. Prezantime grafike të projekt-planeve të thjeshta (p.sh. në diagramë Gantt). Përcaktimi i piketave. <ul style="list-style-type: none"> Rëndësia e raportimit të rregullt tek klienti. Strategjitë për ndërhyrje të thjeshta në rast të vonesave. Dokumentimi i progresit të projektit. <ul style="list-style-type: none"> Metodat për sigurimin e cilësisë (testimi, rishikimi, etj.). Sjellja dhe strategjitë në rast të ankesave. <ul style="list-style-type: none"> Metodat për të nxitur bashkëpunimin. Dhënia dhe marrja e reagime (rregullat e reagime të mirë). Dokumentimi i mësimave të nxjerra.
Qëndrim	<ul style="list-style-type: none"> Vlerësim dhe gjykim realist i aftësive personale. Punë e strukturuar sipas planit të projektit. Marrja e përgjegjësisë. Zhvillimi dhe të menduarit në variante dhe opsione. Diskutimi dhe krahasimi i zgjidhje të ndryshme. Testimi dhe sigurimi i cilësisë, si sjellje standard.
Objekti	Projektet të vogla, fiktive apo reale, me një kohëzgjatje (disa ditë), burime (deri në 3 punonjës) dhe buxhet, të kufizuar.

9 Modulet e klasës së 11

9.1 Zbatimi i një LAN-i të vogël

Titulli	Zbatimi i një LAN-i të vogël
Kodi	M-26-1095-20
Fusha e kompetencës	Menaxhim Rrjeti
Niveli	Klasa 11 (Niveli II i KSHK)
Parakusht	M-26-1089-15: Instalimi dhe konfigurimi i një kompjuteri
Kohëzgjatje	68 orë
Kompetencë	Lidhja dhe konfigurimi i disa kompjuterave me pajisje periferike lokale në një rrjet të vogël “peer-to-peer”.
Aftësi	<ol style="list-style-type: none"> Lidhja fizikisht e pajisjet me kabllo të rrjetit. Konfigurimi i të gjitha pajisjeve me IP statike. Ndarja e burimeve (files, folders) dhe printerave lokale për kompjutera të tjerë. Lidhja e rrjetit lokal në Internet (me modem apo router). Ndarja në rrjet e lidhjes në Internet. Testimi, troubleshooting dhe ndreqja e gabimeve në rrjet.
